



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202101511/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2021

**Lënda:** Rekomandime për inspektimin e bërë në Komisaratin e Policisë Shijak.

**Drejtuar:** Kryekomisar Sali SKURA  
Shef i Komisarimit të Policisë Shijak

**SHIJAK**

**Për dijëni:** Drejtues i Parë Neritan NALLBATI  
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës

**DURRËS**

*I nderuar z. Skura,*

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, dhe nenin 81 i ligjit nr.81/2020 datë 25.06.2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në Komisaratin e Policisë Shijak.

Inspektimi u krye në datën 01.11.2021, sipas një plani inspektimi vjetor të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z. Hazbi Selita, dhe znj. Nertila Qafzezi, nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, "Për miratimin e procedurës standarde, "Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e policisë së Shtetit", si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrijë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

## Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, në mungesë të shefit të komisariatit grupi i punës u takua me specialistin e rendit dhe policimit në komunitet, z. Dritan Dragushi, i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Z. Dragushi, informoi grupin e inspektimit për kushtet në të cilat ndodhet ambienti i shoqërimit, angazhimin e punonjësve të policisë për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave ligjore të personave të privuar nga liria në këto ambiente, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm.

Në vijim, grupi i inspektimit vizitoi ambientet e shoqërimit, zyrat e punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar.

Theksojmë se specialisti i rendit dhe policimit në komunitet dhe punonjësit e tjerë të policisë, me të cilët kontaktoi grupi i inspektimit, u treguan bashkëpunues gjatë inspektimit.

Nga verifikimi i masave për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i kryer në vitin 2020, rezultoi se:<sup>1</sup>

1. **Ishte zbatuar rekomandimi**, për lysterjen, pastrimin dhe dizifektimin e ambienteve që ndodhen mjedisin e shoqërimit dhe mbajtjen e tyre në kushte të përshtatshme.
2. **Ishte zbatuar rekomandimi** për garantimin e masave anti COVID 19.

**Ndërkohë, grupi inspektimit konstatoi se:**

3. **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në korridorin e ambientit të shoqërimit në Komisarariatit të Policisë së Shijakut<sup>2</sup>.
4. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për krijimin e një ambienti të përshtatshëm ku intervistohen/merren në pyetje shtetasit, gjatë kryerjes së veprimeve proceduriale nga specialistët dhe punonjësit e policisë.
5. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për krijimin e zyrave të posaçme për intervistimin me persona të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.

Në vijim të inspektimit të vitit të kaluar, grupi i inspektimit kontrolloi gjithashtu, se çfarë masash ishin marrë për parandalimin e përhapjes së virusit, sigurimin e maskave mbrojtëse dhe disifektantëve për stafin, por dhe për qytetarët që marrin shërbime në mjediset e policisë, zbatimin e protokollit shëndetësor për ruajtjen e distancimit social dhe fizik të punonjësive të policisë të kontaktuar me njëri-tjetrin dhe me qytetarët, si dhe

---

<sup>1</sup> Rekomandime për inspektimin e bërë në Komisarariatit të Policisë Shijak, dërguar me datë K4/I 24-2 prot, datë 30.07.2021.

<sup>2</sup> Komisarariatit të Policisë Shijak ka kthyer përgjigje mbi rekomandimet për inspektimin e bërë në këtë institucion, nr.1460/1 prot, datë 26.08.2020.

vendosjen e afisheve në vende të dukshme me rregullat që duhet të ndiqen për parandalimin e saj. Këto rregulla ishin zbatuar kryesisht në mbajtjen e maskës në ambientet e punës. Disinfektanti për pastrimin e duarve ishte në një tavolinë në hyrje të komisariatit, i vendosur në vend të dukshëm në ambientet e shoqërimit. Gjithashtu, ishin afishuar materiale informuese për zbatimin e protokollit shëndetësor për parandalimin e kësaj sëmundje, për ruajtjen e distancës fizike mes njëri-tjetrit dhe me qytetarët.

Në përfundim të inspektimit grupi i inspektimit konstatoi se, megjithëse në Komisaratin e Policisë Shijak ishin marrë disa masa për përmirësimin e standardeve lidhur me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të personave të arrestuar/ndaluar, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika dhe më konkretisht:

### **Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre.**

Në Komisaratin e Policisë së Shijak, ambienti i shoqërimit në përgjithësi ishte i ndërtuar sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019.

Mjedisi i shoqërimit ndodhej në katin e parë të institucionit. Ambienti i shoqërimit përbëhej nga 3(tre) dhoma shoqërimi të ndara më vete 1(një) dhomë shoqërimi për personat e rritur, 1(një) dhomë për gra dhe 1(një) dhomë për të mitur.

Dhomat e shoqërimit ishin me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrimin dhe trajtimin e të shoqëruarve, të pajisura me tavolina dhe stola për të mundësuar qëndrimin ulur të personave. Përmasat e dhomave të shoqërimit ishin 4x4m dhe kishin kapacitet për mbajtjen dhe qëndrimin ulur deri 4 persona për secilën dhomë.

Dhomat e shoqërimit kishin dritare, përmasat e së cilave siguronin ndriçim të nevojshëm natyral. Të treja dhomat gjithashtu kishin ndriçim artificial nga rrjeti elektrik, dyert ishin prej druri, të cilat kishin mundësi për t’u mbyllur nga jashtë. Në përgjithësi të 3 dhomat ishin të pastra, nga ana higjieno-sanitare. Dhoma e shoqërimit nuk kishte sistem ngrohjeje/ftohje.

Në korridorin e ambientit të shoqërimit ndodhej vetëm një tualet, i pajisur me çezëm dhe kishte ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje. Dera e tualetit ishte e prishur dhe pa bravë për mbylljen e saj. Tualeti nuk plotësonte kushtet higjieno sanitare, dhe kishte nevojë për larje, lyerje dhe dezinfektim të herë pas hershëm të saj.

Në këtë komisarati nuk ishte instaluar sistemi i monitorimit me kamera për mbajtjen në vëzhgim në të gjitha ambientet e këtij institucioni. Mbikqyrja me kamera e të gjitha mjediseve të komisariatit Shijak, përveç atyre mjediseve ku çënohet privatësia, është vlerësuar nga ana jonë si një proces thelbësor për tre arsye:

**Së pari**, mbikqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundërligjshme që mund të kryhen, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

**Së dyti**, mbikqyrja me kamera dokumenton shumicën e ngjarjeve brenda ambienteve të komisariatit, si dhe jep garanci për një gjykim objektiv dhe të paanshëm për masat disiplinore apo penale që duhet të merren ndaj individëve përgjegjës.

**Së treti**, dokumentimi filmik është një material mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve dhe mund të nxirren përfundime të vlefshme dhe të paanshme në rekomandimet përkatëse që hartojnë institucionet monitoruese të pavarura.

Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar dhe për rrjedhojë nuk u realizuan intervista lidhur me trajtimin që u bëhet personave nga ana e punonjësve të policisë.

Në Komisariatin e Policisë Shijak, gjatë periudhës 01.01.2021 deri më 01.11.2021 ishin të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar dhe të evindetuar në regjistrin e shoqërimit **259** persona. Gjatë verifikimeve të regjistrave për periudhën e cituar me lart nuk kishte shtetase gra dhe të mitur të shoqëruar në konflikt me ligjin, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 109 dhe 112/1 të ligjit për Policinë e Shtetit.

Gjithashtu, na u bë me dije se personat e shoqëruar nga policia janë të informuar për të drejtat e tyre, që nga fillimi i privimit të lirisë, duke siguruar informacion të qartë verbal në lidhje me të drejtat ligjore/procedurale që ata kanë. **Mekanizmi Kombëtar kërkon dhënien e kopjes së kartës** së të drejtave në momentin e hyrjes në komisarjat, për të garantuar njohuritë e tyre për të drejtat e tyre, të garantuara nga ligji.

Nga verifikimi i regjistrit të marrjes dhe dorëzimit të personave të shoqëruar dhe kopjeve të procesverbalit të veprimeve të kryera nga punonjësi i policisë me personin e shoqëruar, në rubrikën me shënimet në lidhje me ankesat/kërkesat e të shoqëruarve rezultoi se, për vitin 2021 nuk kishte asnjë ankesë të regjistruar.

Gjatë inspektimit nuk u konstatua asnjë rast, apo u administrua ankesë lidhur me ushtrim dhune apo trajtim degradues. Gjatë inspektimit u kqyrën të gjitha zyrat e Oficerëve të Policisë Gjyqësore në të gjitha ambientet e Komisarjatit. Në zyrat e lartpërmendura nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë ndaj shtetasve që intervistohen/merren në pyetje.

Marrja në pyetje dhe intervistimi i personave të shoqëruar, në mungesë të një ambienti më vete, kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë. Dhomat e shoqërimit dhe zyrat e punës të punonjësve të policisë, nuk monitoroheshin nga sistemi i kamerave.

Më tej u evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme ku rezultoi se, në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë të komisarjatit, mbaheshin procesverbalet përkatëse dhe një kopje e firmosur i jepej personit të shoqëruar.

Në mjedisin e shoqërimit, grupi i inspektimit, nuk gjeti sende apo mjete të tilla që mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve apo për kundërveprim ndaj punonjësve të policisë.

Në korridorin dhe brenda në dhomat e shoqërimit, ishin afishuar postera me të drejtat e personave të shoqëruar në mjediset e policisë, si dhe personave të ndaluar/arrestuar, të cilat ishin të aksesueshme nga këta persona.

Në kohën e kryerjes së inspektimit, si u raportua edhe më lart nuk kishte asnjë person të shoqëruar në mjediset e komisarjatit, për rrjedhojë grupi i inspektimit nuk realizoi intervista lidhur me trajtimin që iu bëhet personave nga ana e punonjësve të policisë nga

momenti i shoqërimit, gjatë kohës së qëndrimit në dhomat e shoqërimit, marrjes në pyetje apo intervistimin e tyre.

### **Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre.**

Në Komisarlatin e Policisë Shijak nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar, në përfundim të veprimeve procedurale nga ana e punonjësve të policisë, dërgoheshin menjëherë në dhomat e sigurisë të Komisarlatit të Policisë të Durrës.

### **Regjistri për evidentimin e personave të shoqëruar, si dhe trajtimi i të shoqëruarve, gjatë veprimeve që kryen policia.**

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisarlatin e Policisë Shijak, “*Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar*” ishte i ri sipas tipit “Model nr.1”, konform procedurave standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*”, miratuar me Urdhrin nr.938 datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Ky regjistër ishte i sekretuar.

Personat e shoqëruar në mjediset e policisë, sipas dispozitave të ligjit nr.108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*”, i ndryshuar, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga kqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrimit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë në zyrën e informacionit<sup>3</sup>.

Në këtë komisarlat kishte regjistër për personat e arrestuar/ndaluar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga kqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën në momentin e shoqërimit të tyre në organin e policisë.

Nga inspektimi, u konstatua se komisarlati i Policisë Shijak, ishte pajisur me një regjistër të posaçëm, vetëm për të miturit në konflikt me ligjin. Nga kqyrja e këtij regjistri rezultoi se gjatë vitit 2021 nuk kishte të shoqëruar të mitur në konflikt me ligjin. Ky regjistër ishte hapur në zbatim të rekomandimit të Avokatit të Popullit, për marrjen e masave, për pajisjen e komisarlateve të policisë me një regjistër të posaçëm, vetëm për të miturit në konflikt me ligjin.<sup>4</sup>

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisarlat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të Ligjit nr. 108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*”, i ndryshuar, por për periudhën e inspektimit, nuk ishte evidentuar dhe pasqyruar asnjë ankesë apo kërkesë nga këta persona.

<sup>3</sup> *Kreu VII, Procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.*

<sup>4</sup> Detyrim i përcaktuar nga ligji nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.

## **Ambientet e intervistimit**

Në Komisarlatin e Policisë së Shijak, oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e tyre të punës. Këto ambiente nuk ishin të monitoruara me kamera, për vëzhgimin gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

Lidhur me këtë fakt, Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimi i mëparshëm ka rekomanduar marrjen e masave për krijimin e zyrave të veçanta ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, por sikurse u përshkrua edhe më sipër, ky rekomandim nuk është zbatuar ende.

Avokati i Popullit, duke iu referuar standardeve ndërkombëtare<sup>5</sup>, edhe atyre kombëtare e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

Në kreu XIV pika 6/b, të Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, për miratimin e procedurës standarde, “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e policisë së Shtetit”, ku përcakton se, në dhomat e intervistimit/marrjes në pyetje të arrestuarve/ndaluarve për të regjistruar në elektronikë procesin e marrjes në pyetje apo veprime të tjera procedurale hetimore me të arrestuarit/ndaluarit.

Proçesi i monitorimit filmik gjatë marrjes në pyetje të personave të shoqëruar dhe të ndaluar është një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

Komisariati i Policisë Shijak në kushtet aktuale nuk posedonte hapësirë të posaçme për biseda apo intervistim me persona të mitur. MKPT e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se bisedat me fëmijët duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët, pasi nga intervistimi i tyre në kushtet aktuale mund të shkaktohet traumatizim plotësues i fëmijëve.

Nga monitorimi që u bë në disa prej zyrave të punonjësve të policisë në godinën aktuale të Komisarlatit të Policisë Shijak, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

---

<sup>5</sup> “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

## **Ndihma juridike dhe psikologjike**

Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat të caktuar kryesisht.

Punonjësit e policisë i parashtruan grupit të inspektimit, se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet proceduriale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht apo prej prindëreve dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë.

Ndërsa psikologu sigurohej nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, por dhe në bashkëpunim me shkollën e mesme të qytetit të Shijakut. Gjatë verifikimit të regjistrave të personave të shoqëruar u konstatua se procedura e ndjekur nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Shijak ishte zhvilluar konform ligjit.

Në gjykimin e institucionit të Avokatit të Popullit puna e psikologut në vendet ku privohet liria e personit, të tilla si komisarariat apo edhe Drejtoritë vendore të Policisë duhet të jenë të gatshëm dhe të organizojnë punën, në mënyrë të tillë që prania e psikologut të jetë prezente në momentin më të parë të mundshëm në rastet e të miturve. Ky përcaktim referuar edhe parashikimit dhe kuptimit të Kodit Penal për të Mitur, ku përcaktohet shprehimisht se: “Prania e psikologut synon që të miturit në konflikt me ligjin, të miturit viktimë dhe/ose dëshmitar t’i sigurohet pyetja në mënyrën e duhur dhe t’i lehtësohet dhënia e dëshmisë nga ana e tij, duke bërë kujdes për të eliminuar frikësimin ose ndrojtjen e të miturit nga procesi”.<sup>6</sup>

Në raste kur të shoqëruarit paraqesin probleme shëndetësore, ata i shoqërojnë në Qendrën Shëndetësore Shijak, për të marrë ndihmën mjekësore.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet proceduriale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut i cili sigurohej në kohë përmes ndihmës nga shkolla e mesme e këtij qyteti ose nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës dhe qëndronte i pranishëm derisa përfundonte procedura përkatëse.

Gjatë inspektimit, u konstatua se në këtë komisarariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Edhe në nenet 34/b. pika 2 dhe 251 të K.Pr. Penale parashikohet se të ndaluarit/arrestuarit duhet t’i jepet dhe të mbajë me vete një kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit. Rezultoi se ndaj personave të shoqëruar nga punonjësi i policisë mbahej një procesverbal tip i emërtuar “*Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit*”.

---

<sup>6</sup> Neni 16 pika 3 i ligjit nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

## **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave të menjëhershme, për krijimin e dhomës për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar dhe dhomës së intervistimit të personave të arrestuar/ndaluar nga oficerët e policisë gjyqësore.
2. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave të posaçme për intervistim me persona të mitur, duke ofruar një ambjent të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese në korridorin e institucionit ashtu në ambientin e dhomës të shoqërimit në Komisaratin e Policisë Shijak.
4. Marrjen e masave të menjëhershme, për lyerjen, pastrimin, dhe dizifektimin e tualetit në ambientet e dhomave të shoqërimit, dhe mbajtjen e saj në kushte sa më të përshtatshme, si dhe pajisjen me bravë për mbylljen e derës.
5. Marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin e një tualeti të pajisur me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim, brenda apo ngjitur me ambientin e shoqërimit të Komisariatit të Policisë Shijak, për shtetaset femra të shoqëruar ndaluar/arrestuar në konflikt me ligjin.
6. Marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e paisjeve elektrike në dhomën e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.
7. Marrjen e masave të menjëhershme për dhënien e kartës së të drejtave në momentin në të cilin palët hyjnë në komisarjat.
8. Marrjen e masave të menjëhershme që të garantohet sa më parë psikologu në rajonet e policisë në rastet e të miturve në konflikt me ligjin, sipas nenit 16 pika 3 të ligjit nr.37/2017 të “Kodi i Drejtësisë Penale për të miturit”, prania e psikologut synon që të miturit në konflikt me ligjin, të miturit viktimë dhe/ose dëshmitar t’i sigurohet pyetja në mënyrën e duhur dhe t’i lehtësohet dhënia e dëshmisë nga ana e tij, duke bërë kujdes për të eliminuar frikësimin ose ndrojtjen e të miturit nga procesi.



Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.*

**KOMISIONER**

**ERMONELA XHAFA**